



INFORMATA BAZIKE:

Lajmëruesit e Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Ruse është një raport mujor i lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e vëjnë në shënjestër Kosovën, dhe që janë të botuara në mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe.

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbetëria e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED).

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1
10 000 Prishtina, Kosovo
Tel: +383 (0)38 542 778
Web-site: www.kipred.org
Email: info@kipred.org

LAJMËRUESIT E DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

MEDIAT RUSE

MAJ 2020

HYRJE

Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Ruse, synon t'i kundërvihet dezinformatave që e vejnë në shënjestër Kosovën, përmes mbikëqyrjes në bazë mujore të botimeve të përzgjedhura mediale që dalin në Rusi, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë serbe. Mediat e përzgjedhura në gjuhën angleze janë Russia Today, Sputnik, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran, dhe Pravda Report, ndërkaq, në gjuhën serbe është Sputnik Serbia. Pos kësaj, Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën i mbikëqyr edhe lajmet, dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën të botuara nga Kremli dhe nga Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.

Gjatë muajit maj të vitit 2020, TASS-i i ka botuar 3, Russia Today 2, The Duran 2, Newsfronti 4, Sputnik International 1, Newsfront 6, Unz-i 2, dhe Sputnik Serbia 96 lajme që kishin të bënin në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me Kosovën. Ndërkaq, The Moscow Times, Russia Insider, Meduza dhe Pravda Report nuk kanë botuar asnjë lajm që kishte të bënte me Kosovën. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe monitoruese, Kremli nuk e pati asnjë, dhe Ministria e Jashtme Ruse i kishte 2 postime të ndërlidhura me Kosovën në ueb-sajtin e vet.

Një vështrim i kujdesshëm i lajmeve të monitoruara tregon që Sputnik Serbia i kishte 3 artikuj lajmesh që përmbanin dezinformata serioze, ndërkohë që lajmet e tjera të botuara gjatë kësaj periudhe nga mediat e tjera nuk përmbanin ndonjë përmbajtje serioze dezinformuese. Nga ana tjetër, edhe njëri nga postimet e Ministrisë së Jashtme Ruse kishte përmbajtje dezinformuese që kishte të bënte me Kosovën.

DEKONSTRUKTIMI I DEZINFORMATAVE TË ZBULUARA

Lajmërim i Dezinformatës 1

Titulli: Opasno navikavanje na antisrbizam! Gujon objasnio kako Jevreji mogu da budu uzor Srbima [Familjarizimi i rrezikshëm me anti-serbizëm! Gujoni shpjegon se si çifutët mund t'ju bëhen shembull serbëve], **Sputnik Serbia, 2 maj 2020**¹

Artikulli e thekson deklaratën e themeluesit francez të organizatës “Solidarity for Kosovo” [“Solidariteti për Kosovën”], Arno Gujon-it, që pohon se dhuna kundër serbëve në Kosmet nuk ndalet madje as edhe gjatë pandemisë dhe orëve të ngujimit në shtëpi. Ai pohoi që është një numër në rritje i sulmeve të shpeshta kundër serbëve, dhe që në fshatin Banjë, banorëve lokalë iu desht të flinin nëpër hangare gjatë tërë dimrit ashtu që ta mbronin traktorin e tyre nga vjedhja apo shkatërrimi. Gujoni beson se çifutët mund të jenë rol model për serbët, meqë ata nuk duhet të mësohen me anti-serbizmin, ashtu siç çifutët kurrë nuk u mësuan me anti-semitizmin. Sipas tij, edhe përkundrejt terrorit, serbët nuk i braktisin shtëpitë e tyre, meqë ata janë lindur atje, gjyshërit e tyre janë atje, dhe nëse e braktisin atë vend, ata do të jenë të humbur. Gujoni beson që prania serbe aty është e rëndësishme për gjeneratat e kaluara, të tashme dhe të ardhshme të serbëve, meqë ata “janë dëshmi e vazhdimësisë së popullit serb që nga Mesjeta deri në ditët e sotme.”

¹ Nataša Milosavljević “Opasno navikavanje na antisrbizam! Gujon objasnio kako Jevreji mogu da budu uzor Srbima [Familjarizimi i rrezikshëm me anti-serbizëm! Gujoni shpjegon se si çifutët mund të jenë rol model për serbët],” Sputnik Serbia, 2 maj 2020, <https://rs.sputniknews.com/analize/202005021122484832-opasno-navikavanje-na-antisrbizam-gujon-objasnio-kako-jevreji-mogu-da-budu-uzor-srbima-video/>

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) Gujoni është personi i fundit që duhet të flasë për çifutët

Themeluesi i organizatës së ashtuquajtur humanitare “Solidariteti për Kosovën,” Arno Gujon – një qytetar francez ky, që po ashtu e ka edhe shtetësinë serbe – është i njohur mirë për institucionet dhe publikun më të gjerë kosovar. Ai konsiderohet si një përkrahës i fuqishëm i besimeve ideologjike të së djathtës ekstreme, si dhe person me qëndrime të fuqishme anti-amerikane, anti-semite, anti-nacionaliste dhe anti-islamike, çfarë përkrahen anembanë Evropës, dhe po ashtu edhe nga Vladimir Putini. Sipas burimeve të ndryshme, ai ishte edhe kandidat për grupin e supremacistëve të bardhë “Bloc Identitaire.”² I maskuar si humanist, ai për vite me radhë ka shpërndarë, përmes Kishës Ortodokse Serbe, ndihma për popullatën serbe të Kosovës.

Është paradoksale, ironike dhe e papranueshme, që një person që është i njohur aq mirë për anti-semitizmin e tij, është duke u përpjekur ta keqpërdorë tragjedinë e popullit çifut për përfitime dhe propagandë politike. Është e qartë që për vite me radhë misioni i vërtetë i z. Gouillonit ka qenë të llojë kundër njohjes së shtetit të Kosovës, dhe ai në fakt është duke e keqpërdorur ndihmën për popullatën serbe, për t’i arritur qëllimet e veta politike. Ai në disa raste është përpjekur të vijë në Kosovë, dhe në vitin 2018 ai ishte marrë në pyetje nga Policia e Kosovës, pas të cilës ai nuk u lejua të hynte në Kosovë.³

² Shih për shembull Samuel Bouron, “Studying the social conditions that make possible the militant commitment to the extreme right: Ethnography of the training camp of the “Identitaires” – France” [“Studimi i konditave shoqërore që mundësuan përkushtimin militant ndaj të djathtës ekstreme: Etnografia e kampeve të trajnimit të “identitaires” – Franca”], shkrim punues, The European Consortium for Political Research (ECPR) General Conference, Montreal: gusht 2015.

³ Periskopi, “Maskimi pas ndihmave për serbët i ‘humanistit’ francez që iu ndalua hyrja në Kosovë,” Prishtinë, 12 shtator 2018,

<https://www.periskopi.com/maskimi-pas-ndihmave-per-serbet-i-humanistit-francez-qe-iu-ndalua-hyrja-ne-kosove/>

b) Në Ballkan serbët janë ‘kryesit e veprave,’ jo ‘viktima’

Artikulli përpiqet që serbët t’i paraqesë rrejtshëm si viktima në Kosovë dhe më gjerë, duke e krahasuar situatën e tyre me historinë tragjike të çifutëve. Është një fakt i njohur shumë mirë që serbët kanë qenë agresorë që i kanë shkaktuar luftrat në Slloveni, Kroaci, Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë. Gjatë këtyre luftrave, forcat ushtarake, policore dhe paraushtarke serbe kanë kryer gjenocid⁴ dhe krime lufte kundër kroatëve, boshnjakëve dhe shqiptarëve. Vetëm në Kosovë, gjatë konfliktit të vitit 1999, raporti i Human Rights Watch ka dokumentuar “torturime, vrasje, përdhunime, shpërngulje të dhunshme dhe krime të tjera të luftës, të cilat janë kryer nga forcat qeveritare serbe dhe jugosllave kundër shqiptarëve të Kosovës midis 24 marsit dhe 12 qershorit 1999.” Për më tepër, raporti po ashtu e zbulonte “një fushatë të koordinuar dhe sistematike për të terrorizuar, vrarë dhe shpërngulur shqiptarët etnikë të Kosovës, që ishte organizuar nga nivelet më të larta të qeverive serbe dhe jugosllave që ishin në pushtet në atë kohë.”⁵

Më konkretisht, bazuar në burime të ndryshme, Raporti kishte përfunduar që “rreth 10.500 shqiptarë të Kosovës ishin vrarë midis 20 marsit dhe 12 qershorit 1999, me një interval të konfidencës nga 7,449 deri në 13,627.” Pos kësaj, sipas Raportit, “ushtria jugosllave dhe policia dhe paramilitarët serbë, i kishin dëbuar 863.979 shqiptarë nga Kosova, dhe disa qindra mijëra të tjerë ishin të zhvendosur të brendshëm. Këto shifra tregojnë se deri në pjesën e parë të qershorit, 80 përqind e të tërë popullatës së Kosovës, dhe 90 përqind e shqiptarëve të Kosovës, ishin zhvendosur nga shtëpitë e tyre.”⁶

⁴ Masakra e Srebrenicës e vitit 1995 konsiderohet si një vepër gjenocidi dhe krim i luftës nga Tribunali Ndërkombëtar për Krimet në ish-Jugosllavi (ICTY), meqë më shumë se 7.000 burra dhe djem boshnjakë u ekzekutuan gjatë rrjedhës së disa ditëve nga trupat serbe të udhëhequra nga Ratko Mlladiq. Shih, Sabrina Ramet, *The Three Yugoslavias: State-Building and Legitimation 1918-2005* [Tri Jugosllavitë: Shtet-Ndërtimi dhe Legjitimimi 1918–2005], Washington, D.C.: IndianaUniversity Press. 2006, fq. 459-460.

⁵ Për hollësitë lidhur me krimet e luftës në Kosovë gjatë luftës së vitit 1999, shih: “Under Orders: War Crimes in Kosovo” [“Nën Urdhëra: Krimet e Luftës në Kosovë”] Human Rights Watch Report, 2001, https://www.hrw.org/sites/default/files/report_pdf/kosovo_full_low.pdf

⁶ Ibid.

Lajmërim i Dezinformatës 2

Titulli: Koment nga Departamenti për Informim dhe Shtyp për politizimin e krimeve të luftës në Ballkan, **Ministria e Punëve të Jashtme e Federatës Ruse, 25 maj 2020.**⁷

Komenti i Ministrisë së Jashtme Ruse e shpreh “shqetësimin e madh” që “forcimi i qasjes së politizuar të anshme ndaj ngjarjeve të konfliktit të viteve 1990 në Jugosllavi në Ballkan vazhdon edhe më tutje – me një pjesëmarrje të gjerë të organizatave të hamendësuar të pavarura jo-për-profit, të cilat për dekada me radhë kanë qenë duke marrë fonde nga qeveritë Perëndimore, dhe po ashtu kanë qenë klientë të tyre. Ndër të tjera, hetimet nga këta trupa, që ishin themeluar për t’i hetuar “krimet e luftës,” e kanë patur një paragjykim të hapur anti-serb.

Për më tepër, komenti pohon që “është domethënëse që ka patur një rritje të njëkohësishme të këtij tipi të aktiviteteve në Podgoricë dhe në Prishtinë. Motivet në themel për ngjarjet e tashme janë të qarta: që Beogradi të përcaktohet si burimi i të gjitha të ligave gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, dhe që fajësimi të bartet nga ata që kryen krime, tek serbët. Për keqardhje, Mali i Zi tash i është bashkangjitur diskreditimit të Serbisë, madje edhe nëse ky qëndroi pranë fqinjit të vet verior gjatë viteve të atyre përvojave të hidhura paralizuese.”

Pos kësaj, komenti thekson që, “me një cinizëm posaçërisht të ftohtë janë duke u sjellur autoritetet në Kosovë – autoritete këto ku pozitat më të larta mbahen nga njerëzit që ishin të përfshirë drejtpërdrejt në vepra kriminale skandaloze, përfshirë kidnapimet dhe vrasjet me qëllim të trafikimit të paligjshëm të organeve. Zbatimi i drejtësisë lidhur me këta njerëz është i penguar në çdo mënyrë të mundshme; edhe përkundrejt një bollëku dëshmish, Haga nuk ka qenë në gjendje ta fillojë madje as edhe një gjykim të vetëm, edhe përkundrejt asaj që janë bërë dhjetë vite qyshse anëtar i PACE, Dick Marty, i ka vënë në dukje praktikat e tmerrshme në raportin e tij. Duke e patur parasysh situatën, këta sponsorisues Perëndimorë në një mënyrë të bindur bëhen

⁷ “Comment by the Information and Press Department on the politicisation of war crimes in the Balkans” [“Koment nga Departamenti për Informim dhe Shtyp për politizimin e krimeve të luftës në Ballkan”] Ministria e Punëve të Jashtme e Federatës Ruse, 25 maj 2020,

https://www.mid.ru/en/web/guest/kommentarii_predstavitelja/-/asset_publisher/MCZ7HQuMdgBY/content/id/4138028

të verbër ndaj spastrimit etnik anti-serb në Kosovë, ndaj vrasjeve të qindra civilëve gjatë agresionit të NATO-s kundër Jugosllavisë në vitin 1999, dhe ndaj pasojave të tmerrshme afatgjata të shfrytëzimit nga ana e aviacionit të NATO-s të bombave me uranium të dobësuar.”

Komenti përfundon duke pohuar që “interpretimi tendencioz i ngjarjeve të 30 viteve të kaluara në territorin e ish-Jugosllavisë, paraqitja e gabuar, përcaktimi arbitrar i fajit, dhe metodat e tjera famëkeqe të ndikimit të politikës, shkojnë në kundërshtim me qëllimin e transformimit të rajonit në një pjesë dinamike dhe pa probleme të Evropës.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) Vënia në dyshim dhe ndërrimi i narrativave për luftën në ish-Jugosllavi, dhe mohimi i krimeve të luftës të Serbisë

Ky koment i Ministrisë së Jashtme Ruse, para së gjithash, dhe mbi të gjithat, synon që t’i vejë në dyshim dhe t’i ndërrojë narrativat e argumentuara dhe të dokumentuara shumë mirë për krimet e luftës në ish-Jugosllavi, duke pohuar që ato e kanë një paragjykim anti-serb.

Ministrisë së Jashtme Ruse duhet t’i rikujtohet që pasojat e luftës në Bosnje e Hercegovinë kanë qenë shkatërrimtare për këtë vend nga aspekti i humbjeve njerëzore dhe i spastrimit etnik, që janë shkaktuar në masën mbizotëruese nga serbët e Bosnjes, të përkrahur fuqishëm nga Millosheviqi. Në total, u vranë më shumë se 100.000 njerëz, shumica e të cilëve ishin myslimanë boshnjakë; serbët e Bosnjes i kishin rreth 24.000 viktima, 4.000 nga të cilat ishin civilë.⁸ Nga ana tjetër, të dhënat e hollësishme të mbledhura duke u mbështetur në 31.600 dokumente dhe të prezantuara në botimin “Kosovo Memory Book” [“Libri i Kujtesës së Kosovës”] (2 shkurt 2015), të përgatitura nga Qendra për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd, i konfirmojnë vdekjet dhe zhdukjet e 13.535 individëve gjatë luftës në Kosovë dhe menjëherë pas saj (1 janar 1998 –

⁸ Për hollësi të mëtejme shih: Daria Sito-Sucic dhe Matt Robinson, After years of toil, book names Bosnian war dead [Pas viteve të mundimit, libri e shpall luftën e Bosnjes të vdekur], Reuters, 15 shkurt 2013, <https://www.reuters.com/article/us-bosnia-dead/after-years-of-toil-book-names-bosnian-war-dead-idUSBRE91E0J220130215>

31 dhjetor 2000). Nga ky numër, 10.812 ishin shqiptarë, 2.197 ishin serbë, ndërkohë që 526 viktima ishin romë, boshnjakë, malazezë, dhe jo-shqiptarë të tjerë.⁹ Për më tepër, sipas UNHCR, mbi 850.000 veta janë dëbuar ose e kanë braktisur vendin të përballur me mizoritë serbe.¹⁰

b) Vënia në dyshim e përpjekjeve për drejtësi tranzicionale në Kosovë

Odat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë u themeluan në vitin 2015, si reagim ndaj raportit të anëtarit të PACE, Dick Martyt, të 7 janarit 2010.¹¹ Vetë fakti që ishin më tepër se 200 qytetarë të Kosovës që u intervistuan nga Prokuroria e këtyre Odave deri në fundin e vitit të kaluar¹² është një dëshmi e qartë që këto Oda nuk janë duke i fshehur krimet e pretenduara. Për më tepër, kohëve të fundit, Prokurori Special ka filluar dy procedura, një në shkurt, dhe tjetrën në prill të vitit 2020.¹³

Për më tepër, Ministria e Jashtme Ruse nuk është duke e përmendur faktin thelbësor, se gjatë periudhës 1999–2018, institucionet e drejtësisë së Kosovës i kanë akuzuar për krime lufte 111 individë, dhe atë 61 shqiptarë, 44 serbë, 5 malazezë dhe 1 rom. Nga 61 shqiptarët e akuzuar, 34 janë dënuar, 23 janë liruar, 2 janë në arrati, dhe 2 janë ende në procedura gjyqësore. Nga 44 serbët e akuzuar, 4 janë dënuar, 13 janë liruar, dhe 24 janë në arrati.¹⁴

⁹ Qendra për të Drejtën Humanitare: 31,600 dokumente pa dyshim konfirmojnë vdekjen apo zhdukjen e 13,535 individëve gjatë luftës në Kosovë, 6 janar 2015, http://www.hlc-rdc.org/?page_id=14390&lang=de. Baza e të Dhënave e Librit të Kujtesës së Kosovës është në dispozicion online në: www.kosovomemorybook.org

¹⁰ Shih për shembull: UNHCR, Kosovo Crisis Update [UNHCR, Përditësimi për Krizën e Kosovës], 4 gusht 1999, <https://www.unhcr.org/news/updates/1999/8/3ae6b80f2c/kosovo-crisis-update.html>

¹¹ Kosovo Specialist Chambers and Specialist Prosecutors' Office, Background [Odat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Special, Prapavija], <https://www.scp-ks.org/en/background>

¹² Shih, për shembull: Gazeta Express, Mbi 200 persona të intervistuar nga Gjykata Speciale, a do të ndodhin arrestimet e para këtë muaj, <https://www.gazetaexpress.com/mbi-200-persona-te-intervistuar-nga-gjykata-speciale-a-do-te-ndodhin-arrestimet-e-para-kete-muaj/>

¹³ Press Statement, Specialist Prosecutor initiates additional proceedings [Deklaratë për Shtyp, Prokurori Special fillon procedura shtesë], Kosovo Specialist Chambers and Specialist Prosecutors' Office [Zyra e Odave Speciale të Kosovës dhe e Prokurorit Special], 28 prill 2020, <https://www.scp-ks.org/en/specialist-prosecutor-initiates-additional-proceedings>

¹⁴ Për hollësi të mëtejme shih: An Overview of the War Crimes Trials in Kosovo: 1999 – 2018 [Pasqyrë e Gjykimeve të Krimeve të Luftës në Kosovë 1999–2018], Qendra për të Drejtën Humanitare, tetor 2018, <http://www.hlc-kosovo.org/wp-content/uploads/2018/10/HLC-Kosovo-An-overview-of-war-crime-trials-in-Kosovo-1999-2018.pdf>

Nga ana tjetër, institucionet e drejtësisë serbe për krimet e kryera në Kosovë deri më tash i kanë dënuar 17 serbë, që gjatë luftës ishin ushtarë apo policë, por asnjëri prej tyre nuk i takonte hierarkisë komanduese, ndërkohë që Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e Luftës në Jugosllavi i ka dënuar gjashtë përfaqësues të nivelit të lartë të Serbisë.¹⁵

Lajmërim i Dezinformatës 3

Titulli: Will Germany's Kosovo policy shift back in Serbia's favor? [A do të zhvendoset politika gjermane për Kosovën në favor të Serbisë?] **The Duran, 18 maj 2020**¹⁶

Ky artikull e diskuton politikën parlamentare të Gjermanisë, dhe, ndër të tjera, pohon se “Që nga koha kur Kosova e bëri shpalljen e vet jo të ligjshme të pavarësisë, në vitin 2008, kjo është shndërruar në një ‘parajsë të kontrabandistëve’ për heroinë dhe në një qendër për trafikimin njerëzor, për marrjen e organeve dhe trafikimin e armëve, dhe kjo e tëra bëhet para syve të KFOR-it.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) Vënia në dyshim e legalitetit të pavarësisë së Kosovës

Para së gjithash, dhe mbi të gjithat, nuk ka patur as edhe një rezolutë të vetme të KB që në mënyrë të qartë Kosovën ia ka caktuar Serbisë si të tillë; e vetmja që është në fuqi (1244), Kosovën e njeh si pjesë të Republikës Federale të Jugosllavisë që nuk ekziston më. Së dyti, shpallja e pavarësisë ka qenë rezultat i procesit negociator të mandatuar nga KB për statusin e Kosovës,

¹⁵ Blakaj: Në Kosovë për krime luftime janë dënuar gjashtë serbë, në Serbi për krime të kryera në Kosovë janë dënuar 15 serbë [Bekim Blakaj, Drejtor i Zyres në Kosovë i Fondit për të Drejtën Humanitare], Telegraf, 15 mars 2019. <https://telegrafi.com/blakaj-ne-kosove-per-krime-lufte-jane-denuar-gjashte-serbe-ne-serbi-per-krime-te-kryera-ne-kosove-jane-denuar-15-serbe-video/>

¹⁶ Will Germany's Kosovo policy shift back in Serbia's favor? [A do të kthehet politika e Gjermanisë për Kosovën në favor të Serbisë?], The Duran, 18 maj 2020, <https://theduran.com/will-germanys-kosovo-policy-shift-back-in-serbias-favor/>

që është udhëhequr nga i Deleguari i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Presidenti Marti Ahtisaari, e në të cilin proces Rusia ishte e përfaqësuar në ekipin e Presidentit Ahtisaari përmes diplomatit të saj të lartë, z. Peter Ivancov. Më 2 shkurt 2007, Presidenti Ahtisaari e paraqiti Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës që e parashihte pavarësinë e mbikëqyrur për Kosovën,¹⁷ i cili u përkrah nga Sekretari i Kombeve të Bashkuara, Ban Ki Moon¹⁸ dhe nga Kosova, por u refuzua nga Serbia.¹⁹ Në fund, më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) e dha opinionin e vet këshillues që konfirmonte që shpallja e pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008 nuk e kishte shkelur të Drejtën Ndërkombëtare.²⁰

b) Paraqitja e Kosovës si një shtet kriminal dhe vënia në dyshim e rolit të KFOR-it

Niveli i kriminalitetit në Kosovë nuk dallon nga ai i vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, përfshirë këtu edhe trafikimin dhe krimin e organizuar,²¹ dhe KFOR-i është institucioni më i besuar i sigurisë ndër të gjitha komunitetet në Kosovë.²²

¹⁷ Shih tekstin e plotë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, https://web.archive.org/web/20091015082628/http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf

¹⁸ UN Report Recommends 'Supervised Independence' For Kosovo [Raporti i KB e Rekomandon 'Pavarësinë e Mbikëqyrur për Kosovën], Radio Evropa e Lirë, 26 mars 2007 <https://www.rferl.org/a/1075514.html>

¹⁹ Reuters, Kosovo says Yes to U.N. plan, Serbia says No [Kosova i thotë Po planit të KB, Serbia i thotë Jo], 2 shkurt 2007, <https://www.reuters.com/article/idUSL02151096.CH.2400>

²⁰ Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Mendim Këshillues për pajtimin me të drejtën ndërkombëtare të shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës, 22 korrik 2010, <https://www.webcitation.org/5rRB9e3bz?url=http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf>

²¹ Për hetim të mëtejshëm shih: HOTSPOTS OF ORGANIZED CRIME IN THE WESTERN BALKANS: Local vulnerabilities in a regional context [PIKAT E NXEHTA TË KRIMIT TË ORGANIZUAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR: Cenueshmëritë lokale në kontekstin rajonal], Global Initiative Against Transnational Organized Crime, Geneva, 2019, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-English-13Jun1110-Web.pdf>

²² Shih, për shembull: Faton Bislimi, Public Pulse 1 [Pulsi Publik 1], UNDP Kosovë, shtator 2013, https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/-/

Lajmërim i Dezinformatës 4

Headline: Упозорење ЕУ: Наговештај напада на Србе на Косову или брига због иницијативе Америке [Paralajmërim për BE-në: Paralajmërim për sulmet kundër serbëve në Kosovë, apo shqetësim për nismën e Amerikës], **Sputnik Serbia**

Artikulli pohon që “Zyra e BE-së në Kosovë ka deklaruar që është e shqetësuar për incidentet kundër komuniteteve jo-shumicë, dhe posaçërisht kundër serbëve të Kosovës. A është Brukseli duke paralajmëruar për ndonjë rrezik real, apo a janë ata duke u përpjekur të “tregojnë” që ata po ashtu mendojnë për serbët para negociatave midis Beogradit dhe Prishtinës, për shkak të parësisë që Amerika e mori nga BE-ja në këtë proces.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Ky artikull është një dezinformim i plotë dhe i pastër, meqë Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë nuk e ka lëshuar kurrfarë deklaratë e cila i shpreh shqetësimet e saj rreth sulmeve të hamendësuar kundër komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, në përgjithësi, dhe kundër komunitetit serb, në veçanti.²³

²³ Shih: Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Materiali i Shtypit, https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/search/site_en?page=2&f%5B0%5D=sm_specific_content_type%3Aeeas_press%3Aall&f%5B1%5D=im_field_regions%3A321&search_token=o723U8OfUGuClx6p-1rePhvLcUTgHe1WG3IBGatQGxA